

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“Mirdita Dental ” SHPK**

Sot, më datë 01.11.2023, u paraqit personalisht:

- **Z.Eriold Dodaj** i datëlindjes 16.06.1983, shtetas shqiptar, lindur ne Rreshen , Mirdite dhe banues ne Tirane, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i kartes se identitetit me nr I30616065H.
- **Znj. Blerta Dodaj** e datëlindjes 31.01.1988, shtetase shqiptare, lindur ne Rreshen , Mirdite dhe banues ne Tirane, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtese e kartes se identitetit me nr I85131056O.

Te cilet përpiluan këtë akt -themelimi të shoqërisë tregtare **“Mirdita Dental ”** shpk, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

**Forma Ligjore**

Të themeloj Shoqërinë Tregtare **“Mirdita Dental ”** shpk, në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht me emrin **“Mirdita Dental”** shpk, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statutin e shoqërisë.

**NENI 2**

**Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.**

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme tregtare.Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë tërësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

**NENI 3**

**Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin e subjektit **“Mirdita Dental”** shpk dhe me emrin tregtar **“Mirdita Dental ”** shpk Ajo do të ketë edhe vulën e saj sipas legjislacionit ne fuqi.



**NENI 4**  
**Objekti i veprimtarisë**

Sherbime Dentare, Heqje dhe mbushje dhembesh, Kirurgji Orale , Implantologji, Rikonstruksion dhe Rigjenerative te Kockave te Nofulles, Implantoproteza. Rehabilitim protezik i dhembeve , terapi dentare , Ortodonci, dhe çdo sherbim tjetër dentare te nevojshem ne funksion te klinikes. Importe mallrash dhe materialesh dentare dhe cdo veprimtari tjetër te lejuar me ligj.

**NENI 5**  
**Selia e Shoqërisë dhe Afati**

Shoqëria “**Mirdita Dental** ” shpk do ta kete seline ne Tirane, Shqiperi me adrese: Njesia Bashkiake nr 5, Rruga Laprake Hyrja 1 , me Zona Kadastrale 8310, Nr Pasurie 10/294+1-4, Vol 6, Fq 98 Laprake, Tirane.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.

**NENI 6**  
**Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar është **500.000 (peseqind mije )** lek dhe zotërohet nga ortakët themelues:

Vlera totale e kapitalit te regjistruar eshte: **500.000 (peseqind mije )**

Vlera e paguar: **500.000 (peseqind mije )**

Numri total i kuotave: **2.**

Kapitali themeltar eshte mbuluar tërësisht nga ortakët themelues.

**NENI 7**

Ortaku themelues i Shoqërisë Tregtare “**Mirdita Dental** ” zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

- Ortaku themelues : **Z. Eriold Dodaj**

Vlera e Kapitalit ne lek **255.000 lek**

Numri i pjeseve : **1,00**


Pjesemarrja ne perqindje (%) **51,00 %**

- Ortaku themelues : **Znj. Blerta Dodaj**

Vlera e Kapitalit ne lek **245.000 lek**

Numri i pjeseve : **1,00**

Pjesemarrja ne perqindje (%) **49,00 %**



Duke qene se Kapitali themeltar do te depozitohet ne llogarine e Shoqerise e cila do te hapet pas regjistrimit ne QKB, atehere ortaku vendos qe kjo shume do te paguhet prej tij jo me vone 3 muaj nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB, ne llogarine e shoqerise tregtare.  
Rregullat e pageses se kesaj shume jane parashikuar ne Statut.

## NENI 8

### Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

## NENI 9

### Administratori/ët

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit/ëve i cili zgjidhen për një mandat 5 (pese) vjeçar nga data 01/11/2023 me të drejtë rizgjedhje. Administratori i shoqerise do te jete :

- **Znj. Blerta Dodaj** i datëlindjes 31.01.1988, shtetas shqiptar, lindur ne Rreshen , Mirdite dhe banues ne Tirane, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i kartes se identitetit me nr I851310560.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administrator/ët, duke i ushtruar këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

## NENI 10

Oratku/ Ortakët mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

## NENI 11

Ortaku/Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

## NENI 12

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.


## NENI 13

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaket Themelues, u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimit hartohet në gjuhën shqipe.

### ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

“Mirdita Dental ” shpk

**Eriold Dodaj**



**Blerta Dodaj**

